KËRKESË
Nr. 31/7, datë 19.7.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga projekti "Hapje rruge në lagjen 'Pjetër Budi', Njësia Administrative Burrel"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Mat.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "truall", vlerësimi bëhet bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", ndërsa vlerësimi ndërtesës është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit "ndërtesë banimi ose jo banimi", i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Mat, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,299,937 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "HAPJE RRUGE NË LAGJEN 'PJETËR BUDI', NJËSIA ADMINISTRATIVE BURREL"', BASHKIA MAT

Lista emerore paraprake e pronareve, pasurite e paluajtshme, prone private te te cileve shpronesohen nga realizimi i projektit "Hapje rruge ne lagjen 'Pjeter Budi', Njesia Administrative Burrel, Bashkia Mat

Nr.	PRONARI			TE DHENA HIPOTEKORE										"TRUALL"			"NDERTESE"			VLERA TOTALE (lekë)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose Qyteti	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Are" (m2)	"Truall" (m2)	"Ndërtesë" (m2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	
	A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	O	P	Q	R	S	T	Y
1	Muharrem	Mehmet	KOLAVERI	Burrel	1326	3/113	Truall+ Ndërtesë	26.9		26.9	26.9	13	195	26.9	1306	35131	26.9	44300	1191670	1226801
2	Mikel Skënder Elvira Melita Vera Maryse Aleksandër	Mirgin Xhelal Xhelal Xhelal Xhelal Mirgin	ZOGU ZOGU ZOGU ZOGU ZOGU FERNANDO ZOGU	Burrel	1326	3/112	Truall	112		112		13	194	56	1306	73136				73136
SHUMA PARAPRAKE																108267			1191670	1299937